



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0663

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Batisha Ibrahimimi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) SEFERI-CO SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit të KOMUNA SUHAREKË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Projekt me bashkfinancim - Ndertimi i rruges Suharekë-Peqan-Peqan i vogël me numër të prokurimit 624-25-4463-5-1-1, me 10.09.2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e SEFERI-CO SH.P.K., me nr. 2025/0663, e datës 18.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Projekt me bashkfinancim - Ndertimi i rruges Suharekë-Peqan-Peqan i vogël me numër të prokurimit 624-25-4463-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA SUHAREKË.

2. **Mbetet në fuqi** njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit Projekt me bashkfinancim - Ndertimi i rruges Suharekë-Peqan-Peqan i vogël me numër të prokurimit 624-25-4463-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA SUHAREKË. **AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.**

3. Lejohet kthimi i mjeteve dhe OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 01.06.2025, KOMUNA SUHAREKË., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Projekt me bashkfinancim - Ndertimi i rruges Suharekë-Peqan-Peqan i vogël me numër të prokurimit 624-25-4463-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **940,000.00 €**.

Me 10.07.2025, OE SEFERI-CO SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 14.07.2025, Autoriteti Kontraktues e ka aprovuar pjesëeisht kërkesën për rishqyrtim kërkesën për rishqyrtim.

Me 18.07.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE SEFERI-CO SH.P.K., me nr. 2025/0663 lidhur me aktivitetin Projekt me bashkfinancim - Ndertimi i rruges Suharekë-Peqan-Peqan i vogël me numër të prokurimit 624-25-4463-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues SEFERI-CO SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 04/L 237, Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092)

Neni 7 – Parimet Themelore të Prokurimit Publik • 7.1: Prokurimi publik duhet të bazohet në parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë. • 7.2: Autoriteti kontraktues nuk duhet të vendosë kërkesa që diskriminojnë ose favorizojnë ndonjë operator ekonomik në mënyrë të pajustificuar. • 7.3: AK është i obliguar të sigurojë trajtimin e barabartë dhe jo-diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.

Neni 59 – Kapaciteti ekonomik, financiar dhe teknik/profesional • Kriteret për kualifikim duhet të jenë: o Të arsyeshme dhe proporcionale me natyrën dhe madhësinë e kontratës; o Të domosdoshme objektivisht për përmbushjen e kontratës; o Jokufizuese për pjesëmarrjen në mënyrë të panevojshme. Ndryshimet përmes Ligjit Nr. 05/L-068 • Ky ligj përcakton se Autoritetet Kontraktuese nuk duhet të përdorin kushte të panevojshme, që nuk lidhen drejtëpërdrejt me realizimin e kontratës dhe që mund të kenë efekt kufizues apo diskriminues në konkurrencë.

Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (e ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024)

Neni 27 – Kushtet për pjesëmarrje • Kushtet për pjesëmarrje duhet të jenë: o Të lidhura drejtëpërdrejt me natyrën dhe objektin e kontratës; o Proporcionale dhe të arsyeshme; o Të mos kërkojnë përvojë të tepërt, certifikata jorelevante apo pajisje jo të nevojshme për përmbushjen e kontratës. Neni 28 – Përshkrimi teknik • Përshkrimi teknik nuk duhet të përmbajë marka tregtare, specifikime të kufizuara, ose referenca të veçanta, përveçse kur kjo është e domosdoshme dhe e arsyetuar qartë nga natyra e kontratës. **KËRKESAT PËR KAPACITETIN TEKNIK DHE PROFESIONAL** Mbështetje ligjore: • Neni 7, Ligji Nr. 04/L-042: Prokurimi publik duhet të bazohet në parimet e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë. • Udhëzuesi

002/2024: Vlerëson si të paarsyeshme kriteret për stafin që nuk janë të lidhura drejtëpërdrejt me përmbushjen e kontratës. KËRKESAT PËR PAISJE TË VEÇANTA Përcaktimi i kërkesave për makineri specifike, që tejkalojnë nevojat reale për kryerjen e punimeve, nuk është i arsyetuar teknikisht dhe kufizon pjesëmarrjen në mënyrë disproporcionale. Mbështetje ligjore: • Neni 28, Rregullorja Nr. 001/2022 (e ndryshuar me 002/2024): Specifikimet teknike duhet të jenë neutrale dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Për arsye të kapacitetit të madh gjeni ne E-Prokurim, komplet ankesen nga OE ankues, tek Shtojca 1.

Përgjigje e Autortitetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim: SEFERI-CO SH,P,K me adresë në Suharekë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Projekt me bashkfinancim - Ndertimi i rruges Suharekë-Peqan-Peqan i vogël me Numër të prokurimit: 624-25-4463-5-1-1 Numër i brendshëm: 624-25-43-511 Kundër (NJOFTIM PËR KONTRATË TE AK), të datës: 02.06.2025 të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 10.07.2025 sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Pas verifikimit të të dhënave në lidhje me pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të paraqitura nga ana juaj, ne kemi konstatuar se kërkesa juaj është pjesërisht e bazuar, andaj AK do të beje korigjimin e dosjes së tenderit B54 Formulari standard për korigjimin e gabimeve.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 23.07.2025 ka autorizuar ekspertin/teknik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0633/2025, ndërsa me datë 04.08.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues/teknik me nr. 2025/0633 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, Autoriteti kontraktues nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE SEFERI-CO SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0663 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues: AK – KOMUNA SUHAREKË, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: “Projekt me bashkëfinancim - Ndërtimi i rrugës Suharekë-Peqan-Peqan i vogël”, me numër të prokurimit: 624-25-4463-5-1-1, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë:

Autoriteti Kontraktues ka publikuar në E-Prokurim njoftimin për kontratë më datë 01.06.2025, ndërsa Korrigjimin e Gabimeve në dosjen e tenderit e ka publikuar më datë 14.07.2025.

Operatori Ekonomik ankues, SEFERI-CO SH.P.K., ka paraqitur fillimisht kërkesën për rishqyrtim në AK më datë 10.07.2025 me datë 14.07.2025, AK ka nxjerrë vendim, duke aprovuar kërkesën si pjesërisht të bazuar dhe ka vendosur që të vazhdojë me procedurat e me tutje lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

OE ankues me vendimin e pa kënaqur të AK-së ka vazhduar dhe ka paraqitur ankesë më datë 20.04.2025, pranë OSHP-së, kundër kriterëve të vendosura në njoftimin për kontratë si dhe kundër dosjes së tenderit të AK-së. Eksperti shqyrtues vlerëson pretendimet si më poshtë:

Përgjigjeje në pretendimet ankimore:

Eksperti shqyrtues sqaron kriteret e vendosura në FDT, tek Kërkesat mbi Mundësitë Teknike dhe/ose Profesionale në piken 9.1 dhe 9.2, në pozicionin 2, është kërkuar:

Kapaciteti teknik dhe profesionale:

Kërkesa 2 - Një (1) Menaxheri i projektit i cili duhet të jetë nxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi konstruktivë me 5 vjet përvojë pune pas diplomimit, të ketë menaxhuar jo më pak se 1 projekte të infrastrukturës rrugore, të jetë i çertifikuar për menaxhim kantieri, si dhe i çertifikuar për siguri dhe mbrojtje në punë, OE duhet ta caktoj me vendim menaxherin e projektit për këtë projekt.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 2 - Kontrata e punës, ose parakontrata me inxhinierin për këtë projekt, kopja e diplomës, CV e nënshkruar nga vet personi, dëshmi mbi përvojën e punës, çertifikata për menaxhim kantieri si dhe çertifikata për shëndetin dhe sigurinë në punë.

Eksperti shqyrtues analizon dhe vlerëson pretendim ankimor si pjesërisht i bazuar, me arsyetimin se AK ka kërkuar “jo më pak se 1 projekte të infrastrukturës”, rekomandimi ynë është që në këtë kriter të shtohet: (jo më pak se 1 projekte të infrastrukturës dhe natyrës së ngjashme), sepse konsiderojmë se është kriter kufizues vetëm në infrastrukturë.

Kërkesa 3 - Një (1) inxhinier bachelor i komunikacionit me 5 vjet përvojë pune pas diplomimit, të ketë menaxhuar jo më pak se 1 projekte të infrastrukturës rrugore, të jetë i çertifikuar për siguri dhe mbrojtje në punë,

Dëshmia 3 - Kontrata e punës, ose parakontrata me inxhinierin për këtë projekt, kopja e diplomës, CV e nënshkruar nga vet personi, dëshmi mbi përvojën e punës, çertifikata për shëndetin dhe sigurinë në punë.

Eksperti shqyrtues analizon dhe vlerëson pretendim ankimor si pjesërisht i bazuar, sepse AK ka kërkuar “jo më pak se 1 projekte në infrastrukturën rrugore”, rekomandimi ynë është që në këtë kriter të shtohet: (jo më pak se 1 projekte të infrastrukturës dhe natyrës së ngjashme), dhe

konsiderojmë se nuk është e nevojshme që të jete i certifikuar për mbrojtje dhe siguri në punë, për shkak se këtë kriter e plotëson menaxheri i projektit.

Kërkesa 4 - Një (1) Gjeodet i licencuar me 5 vjet përvojë pune pas diplomimit të ket menaxhuar jo më pak se 1 projekte të infrastrukturës rrugore.

Dëshmia 4 - Kontrata e punës, ose parakontrata me gjeodetin për këtë projekt, kopja e diplomës, CV e nënshkruar nga vet personi, dëshmi mbi përvojën e punës.

Eksperti shqyrtues analizon dhe vlerëson pretendim ankimor si pjesërisht i bazuar, sepse AK ka kërkuar “jo më pak se 1 projekte në infrastrukturën rrugore”, rekomandimi ynë është që në këtë kriter të shtohet: (jo më pak se 1 projekte të infrastrukturës dhe natyrës së ngjashme), për arsye se Gjeodeti nuk bën vetëm matje të rrugëve por edhe projekte të tjera që janë të natyrës së ngjashme.

Kërkesa 5 - Një (1) inxhinier bachelor ose master i mjedisit, me 5 vjet përvojë pune pas diplomimit.

Dëshmia 5 - Kontrata e punës, ose parakontrata me inxhinierin për këtë projekt, kopja e diplomës, CV e nënshkruar nga vet personi, dëshmi mbi përvojën e punës.

Eksperti shqyrtues analizon dhe vlerëson pretendim ankimor si pjesërisht i bazuar, sepse AK ka kërkuar “Një (1) inxhinier bachelor ose master i mjedisit me 5 vjet përvojë pune”, rekomandimi ynë është që ky kriter të korrigjohet me së paku 3 vite përvojë pune e jo me 5 vite, sepse konsiderojmë që është kriter kufizues dhe diskriminues.

Kërkesa 6 - Një (1) Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë.

Dëshmia 6 - Kontrata e punës, ose parakontrata me personin për këtë projekt, kopja e diplomës, Certifikata për siguri dhe shëndet në punë, CV e nënshkruar nga vet personi.

Eksperti shqyrtues analizon dhe vlerëson pretendim ankimor si të bazuar, sepse AK ka kërkuar “Një (1) ekspert për siguri dhe shëndet në punë”, rekomandimi ynë është që ky kriter është i pa nevojshëm, sepse kërkesa nr.3 e mbulon këtë kriter dhe konsiderojmë që është kriter i dyfishtë që kufizon dhe diskriminon konkurrencën e lirë në treg.

Kërkesa 7 - Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me përvojë pune minimum 5 vjet pas diplomimit.

Dëshmia 7 - Kontrata e punës, ose parakontrata me inxhinierin për këtë projekt, kopja e diplomës, CV e nënshkruar nga vet personi, dëshmi mbi përvojën e punës.

Eksperti shqyrtues analizon dhe vlerëson pretendim ankimor si të bazuar, sepse AK ka kërkuar “Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me minimum 5 vjet përvojë pune”, rekomandimi ynë është që ky kriter është i bazuar dhe nuk ka nevojë të korrigjohet.

Kërkesa 9 - OE duhet të ketë të angazhuar 15 puntor për këtë projekt, ku prej tyre

1. (Një) 1 Teknik i ndërtimtarisë, me 5 vjetë përvojë pune pas diplomimit, të jetë i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë,

1.2 (Një) 1 drenazhues i dheut i çertifikuar, të jetë i çertifikuar edhe për siguri dhe shëndetin në punë,

1.3 (Një) 1 elektrikist i çertifikuar, të jetë i çertifikuar edhe për siguri dhe shëndet në punë.

Dëshmia: 9 - Kontrata e punës, ose parakontrata me personin për këtë projekt, kopja e diplomes dhe çertifikata përkatëse të lëshuara nga autoritetet e liçencuara për këto lloj profesione në R.e Kosovës.

Eksperti shqyrtues analizon dhe vlerëson pretendim ankimor si të bazuar, sepse AK ka kërkuar “15 puntore për këto projekte”, rekomandimi ynë është që ky kriter të korrigjohet dhe të merret fuqia mesatare prej 15 punëtorëve në tri vitet e fundit, sa i përket teknikut të ndërtimtarisë dhe elektrikistit konsiderojmë se këtë dy kërkesa janë të pa nevojshme për arse se mbulohen me kërkesat e dy inxhinierëve paraprak. Ndërsa sa i përket drenazhuesit të dheut, konsiderojmë se është kërkesë e arsyeshme e AK-se.

Dëshmia 10 - Kopje e certifikatave ISO valide.

Eksperti shqyrtues analizon dhe vlerëson pretendim ankimor si të pa bazuar, sepse AK ka kërkuar “ISO Standartet valide”, rekomandimi ynë është që ky kriter është i bazuar dhe nuk ka nevojë të korrigjohet, sepse është në diskrecionin e AK-se që kanë parapare rendësin e projektit dhe vend përfundimtar ku mund të jeni të nevojshme këto ISO.

Kërkesa 11 - Lista e Makinerisë dhe pajisjeve për realizimin e këtij projekti

- 1) (Një) 1 eskavator 23 -25 tonë me zinxhir;
- 2) (Një) 1 eskavator me goma minimum 15-18 tonë;
- 3) (Një) 1 eskavator me goma minimum 3-5 tonë;
- 4) (Një) 1 Grejder rrafshues-nivelizues me goma 8 - 12 tonë;
- 5) (Një) 1 Cilindër ngjeshës me hekur - goma 8 – 12 tonë;
- 6) (Një) 1 rimorkio transportuese e makinerisë 30 - 35 tonë;
- 7) (Një) 1 Rul ngjeshës me hekur – hekur 950 kg – 2.3 tonë për ngjeshje të bankinave;
- 8) (Një) 1 kompaktor me pllak ngjeshëse për rreth lëshesave me pesh 500 – 600 kg;
- 9) (Një) 1 kompresor ajri me 20-22 bar, me pesh 600-1000 kg;
- 10) (Një) 1 Sharr për prerje asfalti dhe betoni;
- 11) (Gjashtë) 6 Kamion transportues me kiper, me pesh bartëse transportuese 10- 35 tonë;
- 12) (Një) 1 makinë ose pajisje për pastrimin e rrugëve, rigollave, dhe sinjalistikës;
- 13) (Një) 1 Cisternë uji mobile me kapacitet 3000 -5000 litra;
- 14) (Një) 1 Makinë - Frezë për grryerjen dhe përpunimin e asfaltit 15–18 tonë.

15) (Një) 1 Paisje-Frezë që montohet në eskavator për grryerjen e asfaltit, betonit dhe gurit, pesha 350 – 500 kg;

16) (Një) 1 Baze per prodhimin e asfaltit. E licencuar nga KPMM;

17) (Një) 1 Finisher per shtrirjen e asfaltit;

18) (DY) Rul per ngjeshje te asfaltit.

Dëshmia 11 - Të gjitha paisjet nga 1 deri në 18 OE duhet ti ketë në pronësi paisjet e makinerisë, nëse nuk i ka mund të ofroj marrëveshje për shfrytëzimin e tyre për këtë project deri në pranim Teknik.

Të gjitha mjetet ose paisjet të cilat regjistrohen të dokumentoj me libreza kopje valide të scanuara, ndërsa ato të cilat nuk regjistrohen, të dokumentohen me DUD doganor, Fatur, nuk pranohen marrëveshjet e përgjithshme.

AK - Autoriteti Kontraktues e ruanë të drejtën e verifikimit të silitit document dhe secilës paisje, makinerisë edhe në terenë.

Eksperti shqyrtues analizon dhe vlerëson pretendimet ankimore për pikat 3, 7, 8, 9, dhe 15 si pjesërisht të bazuara, me arsyetim se:

Pika 3. Sipas hulumtimeve që kemi bërë ekskavatori me goma nga min. 3-5 ton, të korrigohej në 3-9 ton që do të nënkuptohet hapjen e konkurrencës dhe jo diskriminimit.

Pika 7. Sipas hulumtimeve të bëra për këtë lloj të pajisjes tonazhiteti që AK ka kërkuar nga 950 kg-2.3 ton, të korrigohej në tonazhitetin prej 1-3 ton.

Pika 8. Referuar kësaj pike kapaciteti i kësaj pajisje që kërkohet nga 500-600 kg të korrigohej dhe të rritet deri në 1000 kg apo 1 ton.

Pika 9. Për pajisjen kompresor ajri me kapacitet prej 20-22 bar me peshe 600-1000 kg, të korrigohej vetëm pjesa e bareve nga 10-20 bar, por jo edhe pesha në kg.

Pika 15. Pajisja freze që montohet në ekskavator për grryerjen e asfaltit, betonit dhe gurit, pesha e kërkuar nga AK është nga 350-500 kg, të korrigohej dhe të bëhet deri në 1000 kg apo 1 ton.

Ndërsa për pikat e tjera të pretenduara nga OE ankues si:

Pika 1. 2. 4. 5. 6. 10. 11. 12 .13. dhe 14, konsiderojmë se AK ka vepruar drejt dhe për porcion me natyrën e projektit për këto pajisje.

Eksperti shqyrtues, pas vlerësimit të të gjitha pikave të pretenduara nga Operatori Ekonomik ankues, në lidhje me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit nga Autoriteti Kontraktues, rekomandon që Autoriteti Kontraktues të bëjë korrigjimin e pikave të lartpërmendura dhe njëkohësisht të respektojë nenet 7, 51 dhe 52 të Ligjit për Prokurimin Publik. Po ashtu, të bëhet korrigjimi i njoftimit për kontratë dhe të zgjatet afati për dorëzimin e ofertave, në përputhje me afatet ligjore.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Andaj, Paneli nuk i mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij.

Lidhur me pretendimin ankimor për inxhinierat, ekspertit shqyrtues ka cituar Dëshmia 2 - Kontrata e punës, ose para kontrata me inxhinierin për këtë projekt, kopja e diplomës, CV e nënshkruar nga vet personi, dëshmi mbi përvojën e punës, certifikata për menaxhim kantieri si dhe certifikata për shëndetin dhe sigurinë në punë. Eksperti shqyrtues analizon dhe vlerëson pretendim ankimor si pjesërisht i bazuar, me arsyetimin se AK ka kërkuar “jo me pake se 1 projekte të infrastrukturës”, rekomandimi ynë është që në këtë kriter të shtohet: (jo me pake se 1 projekte të infrastrukturës dhe natyrës së ngjashme), sepse konsiderojmë se është kriter kufizues vetëm në infrastrukture. Këtë arsyeshmëri të ekspertit shqyrtues të pa mbështetur të ndonjë argument që e njëjta mund të jetë diskriminuese nuk mund të përkrahet nga ana e Panelit Shqyrtues, sepse Paneli Shqyrtues konsideron që nuk mund të cilësohet si kërkesë diskriminuese përderisa ky aktivitet ka natyrën e infrastrukturës me përshkrimin Ndërtimi i rrugës Suharekë-Peqan-Peqan i vogël, dhe normalisht që inxhinieri duhet të ketë përvojë për aktivitetin që do të zhvillohet. Përveç kësaj AK ka kërkuar që një OE këtë inxhinier mund ta ofroj edhe me para kontratë e jo domosdoshmërisht ta ketë si punëtor të rregullt në momentin e ofertimit.

Lidhur me pretendimin ankimor për certifikatën ISO njëjtë edhe Paneli Shqyrtues sikurse eksperti konstatojnë që nuk është kërkesë diskriminuese.

Lidhur me pretendimet ankimore për Kërkesa 3 - Një (1) inxhinier bachelor i komunikacionit me 5 vjet përvojë pune pas diplomimit, të ketë menaxhuar jo më pak se 1 projekt të infrastrukturës rrugore, të jetë i certifikuar për siguri dhe mbrojtje në punë, Kërkesa 4 - Një (1) Gjeodet i licencuar me 5 vjet përvojë pune pas diplomimit të ketë menaxhuar jo më pak se 1 projekte të infrastrukturës rrugore, Kërkesa 5 - Një (1) inxhinier bachelor ose master i mjedisit, me 5 vjet përvojë pune pas diplomimit. Eksperti shqyrtues përveç që është thirrur në shumet rekomandimi ynë, ndërsa në ekspertizë figuron si i vetëm, i njëjti nuk ofron asnjë argument pse këto kërkesa duhet të ndryshohen dhe në asnjë rrethanë nuk ofron arsyeshmëri apo analizë konkrete kur thotë që në këtë kriter të shtohet: (jo me pake se 1 projekte të infrastrukturës dhe natyrës së ngjashme), ndërsa anën tjetër citon ska nevojë të jetë i certifikuar për punë dhe siguri, po ashtu duke ulur

edhe përvojën e punës së ekspertëve. Kjo metodë e përdor nga ana e ekspertit shqyrtues më shumë shihet si fontanë dëshirash të tij se sa një analizë konkrete të bërë nga ana e tij, dhe nuk përkon fare me detyrat dhe përgjegjësitë e tij, sepse kemi të bëjmë me realizim të projekteve dhe shpenzim të fondeve publike dhe për këtë realizim të projekteve përgjegjëse direkt në këtë rast është autoriteti kontraktues dhe jo eksperti shqyrtues i cili nuk ka marrë mundin të bëjë asnjë hulumtim, pse jo edhe inspektim të terrenit në të cilin do të punohet. Kështu që rekomandimet e tij të pabaza nuk mund të mbështeten nga ana e Panelit Shqyrtues.

Ashtu sikurse nuk mund të përkrahen as rekomandimet tjera lidhur me pretendimet ankimore për Kërkesa 6 - Një (1) Ekspert për Siguri dhe shëndet në punë. Me çrast paneli konsideron se ka ndryshim rreth kërkesës 3 me këtë kërkesë, ngase në kërkesën 3 është për inxhinier I komunikacionit e që ka fushën e ndryshme ku këtu kërkohet ekspert për siguri dhe punë, inxhinieri I komunikacionit me ekspert për siguri dhe punë ka dallime esenciale .andaj konsideroj që kjo kërkesë nuk mund të quhet diskriminuese dhe nuk ka ndonjë argument të tillë përderisa mund të ofrohen edhe me marrëveshje për angazhim apo para kontratë.

Lidhur me pretendimet ankimore për Kërkesën 7 - Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me përvojë pune minimum 5 vjet pas diplomimit dhe Kërkesën 9 - OE duhet të ketë të angazhuar 15 punëtor për këtë projekt, Paneli shqyrtues nuk e sheh si kriter diskriminues për derisa AK e ka parë të nevojshme dhe ka lejuar që të njëjtit mund të ofrohen me marrëveshje për angazhimin e tyre apo para kontratë. Po ashtu edhe në konsistencë me vendimet dhe aktivitetet tjera nuk e sheh si numër të madh të stafit të kërkuar.

Lidhur me pretendimin ankimor për kërkesën 11 - Lista e Makinerisë dhe pajisjeve për realizimin e këtij projekti Vlenë të theksohet se për derisa AK ka lejuar që për të gjitha pajisjet nëse OE nuk i ka në pronësi mund të ofroj marrëveshje për shfrytëzimin e tyre për këtë projekt deri në pranim Teknik. Për Panelin Shqyrtues ky kriter nuk mund të jetë diskriminues dhe nuk mund ta mbështesë ekspertin shqyrtues i cili nuk ka këtë profesionin dhe i njëjti nuk ka kërkuar as ekspert teknik të kësaj fushe për çka është iniciuar kjo procedurë dhe nuk ka ofruar dëshmi , apo ndonjë analize të mirëfillte në raport me para masën nga AK-ja.

Në këtë kontekst, Paneli Shqyrtues, konsideron se ankesa e OE të kualifikohet si pjesërisht e bazuara, por e pamjaftueshme që të obligoj AK që të bëjë përmirësimin në Dosje të Tenderit. Përderisa OE ankues pothuajse i ka atakuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga AK-ja, si dhe në ankesë nuk ka ofruar ndonjë dëshmi që konsiderohet si favorizuese. Njëherit, Paneli nuk ka vërejtur se në këtë procedurë nuk ka ndonjë reagim apo rekomandim nga D. Monitorimit të KRPP-së, dhe pikërisht edhe për këtë nuk mund të marrë përgjegjësi ti ndryshoj kriteret në mungesë të ndonjë argumenti apo prove konkrete.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur që të lejoj AK që të vazhdoj tutje me këto kërkesa të Dosjen e Tenderit/ Njoftimin për Kontratë të Autoritetit Kontraktues Komuna e Suharekës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Projekt me bashkfinancim - Ndertimi i rruges Suharekë-Peqan-Peqan i vogël” me numër të prokurimit: “624-25-4463-5-1-1”.

Pavarësisht, asaj se AK mund të vazhdoj tutje me këto kërkesa, AK gjithëherë ka të drejtë nëse vëren apo konstaton se ndonjëra nga kërkesat mund të jetë diskriminuese mund ti eliminoj të njëjtat.

PSH konsideron se të gjitha autoritetet kontraktuese duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek

diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e produkteve që plotësojnë nevojat adekuate të tyre, si dhe pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet.

Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse. Andaj, AK është përgjegjëse edhe për hartim të DT, sipas nenit 27 dhe 28 të LPP.

Paneli Shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të pjesërishëm të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - SEFERI-CO SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: